



Raporti i vitit 2019 – Komuna e Suharekës

Ju prezentojmë raportin e të gjitha drejtorive të Komunës së Suharekës, për periudhën Janar- Dhjetor 2019.

Raporti përmbanë të gjitha aktivitetet tona të cila janë zhvilluar gjatë vitit 2019. Më tej në kohë reale jeni njoftuar përmes webfaqes zyrtare, e poashtu edhe përmes rrjeteve sociale.

Nëse konsideroni se raporti i prezentuar, ka ndonjë paqartësi apo mangësi, ju lutem drejtohuni me kërkesë zyrtare, natyrisht sipas Ligjit për qasje në dokumente zyrtare, apo edhe në orarin e vizitave të cilat përcaktohen në takime me qytetarë, apo edhe takime të planifikuara që ju të informoheni rreth aktiviteteve tona, të cilat i kemi realizuar gjatë vitit paraprak.

Më poshtë po u prezentojmë raportin e drejtorive komunale:

Drejtoria për Ekonomi Buxhet dhe Financa

- Janë faturuar (2377) biznese me vlerë prej(493,465.00 €);
- Gjithashtu janë faturuar (186) shrytëzues të pronës komunale në vlerë prej (191,822.00 €);
- Janë dërguar (49) vërejtje dhe (90) vërejtje të fundit për në përmbarues;
- Gjatë këtij viti kanë bërë kërkesë(256) biznese për zbritje të Taksës në Aktivitet në vlerë totale të stornuar prej (-119,197.⁰⁰ €).
- Në këtë vitë janë lëshuar (12731) fletëpagesa për regjistrim të automjeteve e që vlera totale e tyre është (128,291.⁰⁰ €).
- Janë lëshuar (3532) vërtetime dhe (226) çertifikata të ndryshme nga zyrtarët për shërbim të qytetarëve,
- Në Qendren e rexhistrimit të biznesit deri me datë 21/06/2019 janë regjistruar (88) biznese individuale, (118) SHPK , (1)ShoqeriAksionare, (216) modifikime, (1190) ndërrime të çertifikatave si dhe janë shuar(87)biznese.

Zyra e Thesarit;

- Nga fillimi i vitit derimë sot (3941) lëndë janë Çertifikuar dhe Aprovuar (14,125,255.04€) pagesa nga të gjitha programet e Komunës së Suharekës.
- Të gjitha këto pagesa, pas Çertifikimit dhe Aprovimit janë sistemuar në (48 regjistrator) dhe janë arkivuar në Arkivin Financiar të KK nëSuharekë.

Zyra për Regjistrimin e Pasurisë ;

- Totali i regjistrimit të pasurisë deri më datë 31/12/2019 është (318,863,182.02€) I pasurive kapitale ndërsa i pasurive jo kapitale (vlera nën 1000.00 €) është (2,139,543.42 €).

Sektori i Tatimit në Pronë;

- Janë faturuar dhe dërguar tek tatim-paguesit(16,309) fatura në vlerë prej(923,314.17 €) dhe faturimi i tokës (trojet dhe malet) në vlerë prej (99,841.26 €).
- Planifikimi i të hyrave të këtyre dy kategorive ka qenë: Tatimi në objekte ndërtimore (715,000.00 €) dhe tatimi në tokën e paluejtshme (181,672.00 €).
- Janë bërë rreth (1881) inspektime në teren ku gjatë këtyre inspektimeve janë regjistruar (498) objekte të reja dhe(318) ndryshime (modifikime) të objekteve,
- Të hyrat nga Tatimi në Pronë (objekte dhe toka) deri me 31/12/2019 janë; (762,259.⁸³€).
- Gjatë këtijë viti janë dërguar gjithsej (460) vërejtje për borgje mbi (1,000.00 €).

Të hyrat vetanake të realizuara deri më datë 31/12/2019;

- Të hyrat nga Tatimi në Pronë ----- (762,259.⁸³€)
- Të hyrat nga Taksa në Aktivitet----- (197,511.⁹⁷ €)

- Të hyrat nga Renta dhe Qiraja ----- (134,516.⁶⁷ €)
 - Të hyrat nga taksa e rexhistrimit të automjeteve----- (128,291.⁰⁰ €)
 - Totali i përgjithshëm i realizimit të hyrave vetanake për vitin 2019 (1,973,199,⁶⁷ €)
 - Totali i të hyrave të planifikuara për vitin 2019 ----- (2,239,252,⁰⁰ €)
 - Përqindja e realizimit të të hyrave për vitin 2019 është----- (0.88 %)
 - Total i të hyrate vitit 2018 -----(1,803,437.⁸⁴ €)
- Diferenca 2019/2018 është= (+169,761.⁸³ €) më shumë**

Total të hyrat e vitit 2019 në DEFB				
	Realizimi	Planifikimi	Diferenca	% Realizimit
TPR	762,259.83	715,000.00	47259.83	1.07
Taksa ne Aktivit.	197,511.97	195,000.00	2511.97	1.01
Qiraja	58,094.43	60,499.99	-2405.56	0.96
Renta	76,422.24	60,499.99	15922.25	1.26
Hyrat te autom.	128,291.00	184,000.00	-55709.00	0.70

Total të hyrat e vitit 2018 në DEFB					Diferenca 2019/2018
	Realizimi	Planifikimi	Diferenca	% Realizimit	
TPR	685,032.20	690,000.00	-4967.80	0.99	77,227.63
Taksa ne Aktivit.	218,448.72	236,000.00	-17551.28	0.93	(-20,936.75)
Qiraja	59,229.56	56,000.00	3229.56	1.06	(-1,135.13)
Renta	75,111.90	56,000.00	19111.90	1.34	1,310.34
Hyrat te autom.	124,180.00	171,000.00	-46820.00	0.73	4,111.00

Raport i shpenzimit të buxhetit deri më datë 31/12/2019

Nr.	Kategoria ekonomike	Buxheti alokuar	Buxheti i shpenzuar	Realizimi %
1	Mallra&Shërbime	1,470,643.88	1,440,183.74	0.98%
2	Subvencione&transfere	300,510.00	298,620.00	0.99 %
3	Shpenzimet Komunale	277,154.31	273,880.50	0.99 %
4	Projekte Kapitale	5,761,196.68	5,292,047.28	0.92%

Buxheti TOTAL Komunal	16,099,642.33	15,572,954.44	0.97 %
------------------------------	----------------------	----------------------	---------------

Drejtoria për Shërbime Pronsore-Juridike dhe Kadastër

Drejtoria e Shërbimeve Pronsore-Juridike dhe Kadastër, gjatë këtij viti ka vazhduar të ofroj shërbime sa më efikase për qytetarët, duke u ofruar informacione dhe të dhëna për pronat e sektorit privat dhe atij komunal.

Gjatë kësaj periudhe në zyrat pritëse të dy sektorëve, sektorin e kadastrit , dhe Sektorin e Prones janë pranuar shumë lëndë.

Në Drejtorin për Shërbime Pronsore-Juridike dhe Kadastër mbahen takime të rregullta me qytetarët. Gjatë takimeve palëve u ipen këshilla për plotsimin e lëndëve sipas kërkesave të palëve.

Këto kërkesa kyesisht kanë të bëjnë me bartje të trashigimisë, regjistrimin ose ç’regjistrime të hipotekave, qirambajtje në periudhë afatshkurtë 1-15 vite, dhe periudhë afatgjatë prej 15-99-vite, kërkesa për ndarje, bashkim ose rregullim të kufijve në mes të palëve.

Palëve ju ofrohet edhe ndihma për identifikim të pronave, sipërfaqes së pronës shfrytëzuesit aktual të pronës, si dhe kemi bërë historiata të parcelave të pronave private .

Gjatë kësaj periudhe Shërbimi Pronsor Juridik dhe Kadastrit ka pasur një bashkëpunim të ngushtë edhe me drejtoritë tjera, dhe në bazë të kërkesave të tyre kemi dalur në teren dhe kemi

identifikuar pronat komunale (rrugët) e uzurpuara të cilat janë liruar për realizimin e projekteve të tyre .

Gjatë kësaj periudhe kemi pasur takime me komisionin për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme Komunale ku kemi zhvilluar procedurat e Ankandve Publike, si dhe Konkurimeve të Hapura .

KONKURIMET E HAPURA PER VITIN 2019

Konkurimet	Vendbanimi/ Vendi	Parcela/Sip.	Destinimi	Përfituesi
Nr.01/2019	Gjinoc “Livadhet e verdha”	00917-0 12435m ² parcela, dhe objekti 1320m ²	“Ofrimin shërbimeve për personat pa përkujdesje familjare”	“Shoqata bamirëse Jetimat e Ballkanit” - Berat Kabashi.
Nr.02/2019	Suharekë Z.Industriale	2785/25 8000M ²	“Depo ndërtimore”	Procedurë
Nr.03/2019	Suharekë Z.Industriale	2785/79nga sipërfaqja e pergj. ndahen 10967m²	“Shkollë profesionale me kuadër të kualifikuar me nivelelin e shkallës së 5 (pestë) drejtimi “Mekatronik”	Procedurë
Nr.04/2019	Suharekë. <u>Banesa</u> , e cila gjendet në rrugën “Brigada 123” në Suharekë	objekti “B” hyrja “H- 4, Nr. 58, kati VIII- S=66.31m², IX- S=66.31m². X- S=66.31m², XI- S=66.31m²	“Banesa per familje të dëshmorëve”	Banesa në katin e VIII me sip. prej 66.31m ² përfitues është Luljeta Sylaj . Banesat tjera janë në procedur .

ANKANDET PUBLIKE 2019

ANKANDET	Vendbanimi/ Vendi	Parcela/Sip.	Destinimi	Përfituesi
Nr.01/2019	Suharekë. Objekti (depoja) në rrugën “Bajram Curri” në lagjen “Slloxha”	Përball Komunes, objekti me sip.279m, dhe parking me sip197m. 15vite.	Objekt , depo	NTSH “Krasniqi” Zeqir Krasniqi
Nr.02/2019	Suharekë. Z.Industriale	02785-1 nga sip. e pergjithsme prej 502304m², 39156m² ipen në shfrytëzim për periudhë 5 vjeqare	Lokacion për trajtimin dhe deponimin e mbeturinave nga ndërtimi dhe demolimi i objekteve ndërtimore .	“OK GROUP”- Besart Kuqi
Nr.03/2019	Suharekë. Z.Industriale	P-02785-79 Nga sip. e pergjithshme ndahen 200m². periudh 10 vjeqare.	Ndërtimi i lokalit afarist me karkter te perkohshem,	Procedurë

Për çdo konkurim të hapur, dhe ankand publik Komisioni Komunal për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale ka përgaditur RAPORT VLERESIMI DHE REKOMANDIMI.

Në Vitin 2019 Drejtoria e Shërbimeve Pronësore-Juridike dhe Kadastër, ka zhvilluar procedura të shpronësimit, si dhe ndërrimit të pronës komunale me pronën private duke u bazuar ne Vendimet e Kuvendit Komunal.

1. **MUSHTISHT.** Objekti me sip. tërgjithshme 220m²i cili menagjhet nga AKP. Që është i ndërtuar në pjesën e P-02390-2 në vendin e quajtur “fshat”. Qëllimi i shpalljes së intersit publik është “Ndërtimi i parkut”.
2. **STUDENÇAN.** Objekti me sip. të përgjithshme 678m² i cili menagjohet nga AKP. Që është i ndërtuar në pjesën e P-02270-0 vendi i quajtur “ Rashica”. Qëllimi: “Çerdhe të fëmijëve dhe këndi për të moshuarit”.

Për këto dy proceura Drejtoria i ka parashtrur kërkesë Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor, për zhvillimin e procedurës administrative për shpronësimin e paluejtshmërisë.

Bazuar në vendimin e Kryetarit të Komunës, për formën e kompensimit të pronës private të planifikuar me dokumente të planifikimit për interes të përgjithshëm, D.SH.P.J.K ka arritur tri (3) marrëveshje për kompensimin e pronës private me bonus ndërtimi në objekt, ku nga këto marrëveshje Komuna ka përfituar pronë në sipërfaqe të përgjithshme prej 1723m².

Në bazë të Vendimit të Asamblesë Komunale, për shpalljen e interesit publik pjesa e parcelës kadastrale P-01073-1 Zk Suharekë vendi i quajtur “Pojata/ Afër Stacionit” eviendtuar në emër të Avdi(Salih) Elshanit, me sip. te përgjithshme prej 585m², nga sip. e përgjithshme interes publik shpallen 116m² .”Zgjerimi i rrugës “Brigada 123” ne qytetin e Suharek. Në bazë të këtij vendimi drejtoria i ka zhvilluar proceduat e kembimit, është edhe AKT-VLERSIMI i Ministrisë.

Lëndët në sektorin e KADASTRIT për periudhën Janar-Dhjetor. 2019

	J.	Sh.	M.	P.	M.	Q.	K.	G.	Sh.	T.	N.	Dh. Deri dt.20. 12.	Gjithse j
Aktvendime për bartjen e pronsisë	83	63	57	49	65	31	56	100	89	51	45	30	719
Aktvendime për ndarjen dhe regjistrimin e parcelave kadastrale	50	19	12	14	34	5	13	12	18	28	7	17	229

Aktvendime për regjistrimin e hipotekes	2	5	8	1	4	4	2	2	4	6	4	6	48
Aktvendime për lirim e hipotekës	0	8	3	2	3	2	3	5	3	5	5	2	41
GJIHSEJT:	135	95	80	66	106	42	74	119	114	90	61	55	1037

	J.	SH.	M.	P.	M	Q	K	G.	SH.	T	N	DHJ .	Gjiths ej
Çertifikata që posedojnë pasuri	368	396	432	238	385	537	600	638	440	464	367	322	5187
Çertifikata që nuk posedojnë pasuri	112	109	118	30	71	113	65	59	65	89	60	104	995
Kopje planit	55	73	131	50	69	30	49	55	49	49	61	45	716
Kërkesa për Kordinata	40	58	25	51	65	33	49	111	61	57	36	34	620
Identifikime në zyrë	141	464	268	266	313	196	185	279	325	310	243	225	3215
Dalje në teren	2	6	13	7	15	9	8	17	12	11	6	6	112
Kontrollimi dhe regjistrimi i lëndëve	50	39	33	48	63	20	47	40	54	55	50	55	
Regjistrimi në C MAP	173	125	32	202	202	52	179	254	160	195	142	150	1866
Ekspertiza	0	1	0	0	3	1	0	0	0	0	0	0	5
Historiate	2	2	4	4	5	5	2	0	0	1	1	1	27

Në Shërbimin Pronësoro-Juridik është vazhduar me lëndët të cilat kanë qenë të pa përfunduara nga vitet paraprake, dhe lëndët e këtij viti.

Kryesisht zyrtarët e Shërbimit Pronësoro-Juridik janë fokusuar në zgjidhjen e lëndëve, të cilat kanë të bëjnë me shpronsimet, ekzekutimet, raporte të ndryshme , njoftime të palëve rreth

pagesës së qeras dhe rentës , lirimin e hapsirave publike , identifikimin e parcelave te lira ne Zonen Industriale në Shirokë, , si dhe dedikimi i veprimtarisë për këto parcela . Gjatë kësaj periudhe janë realizuar edhe dalje në teren nga sektori i pronës.

RAPORTI I PUNËS PËR PERIUDHËN JANAR – DHJETOR 2019 NË SEKTORIN E PRONËS ËSHTË:

Numri i lëndëve Janar - Dhjetor

Lloji i lëndëve	
Kërkesa të pranuar gjatë këtij viti	154
Kërkesa të zgjidhura	133
Në procedure	21
Njoftime të ndryshme për palë	49
Çertifikata për shitblerje të pronave për të cilat komuna nuk ka interes për blerje	57
Pagesa dhe zotimie	50
Dalje në teren	35
Konkluzione për bartje	17
Aktvendime	6

- Ne si drejtori gjatë këtij viti kemi realizuar të hyra nga taksat e qytetarëve.
Në formë tabelare po i sjellim të hyrat për secilim muaj:

1	JANAR	8.335.00€
2	SHKURT	6.547.00€
3	MARS	6.694.00€
4	PRILL	5.010.00€
5	MAJ	8.212.00€
6	QERSHOR	7,764.00€

7	KORRIK	8,586.00€
8	GUSHT	11,955.00€
9	SHTATOR	9,988.00€
10	TETOR	10,478.00€
11	NENTOR	6,542.00€
12	DHJETOR	6,729.00€
	GJITHSEJT	96.840.00€

Gjatë këtij viti kemi pasur takime me Agjensionin Kadastral të Kosovës.

- Gjatë këtij viti kemi pasur 112 dalje në terren nga sektori i kadastrit dhe 35 dalje në terren nga sektori i pronës, ku është bërë piketimi i rrugëve, rrugëve fushore , piketimi i rrugëve të cilat kan shërbyer për hartimin e projekteve.
- Po veçojmë disa nga piketimet dhe inqizimet të cilat janë realizuar nga Drejtoria e Shërbimeve Pronore-Juridike dhe Kadastër:
 - Piketimi i rrugës “ Bardhi” në Bukosh.
 - Piketimi i lumit Suharekë, Sopijë, Leshan, Reqan, Tërrnje , Vraniç, Savrovë.
 - Piketimi i rrugëve lokale : Mushtisht, Bukosh, Suharekë, Leshan, Sopijë, Greikoc, Samadraxhë.
 - Piketimi dhe rilevimi i lapidarit në Samadraxhë.
 - Piketimi dhe rilevimi i çerdhës në Samadraxhë.
 - Rilevimi i Shkollës Mesme Profesionale në Suharekë.
 - Rilevimi dhe piketimi i Byfes te Gjimnazi “Jeta e Re”.
 - Rilevimi dhe piketimi ZK Grejkoc, te Pusi i Atit.
 - Rilevimi i kroit në Greikoc, kufi me Korishën.
 - Rilevimi dhe Piketimi i lëndëve me gjykatë.
 - Rilevimi dhe piketimi i lëndëve me shërbimin e pronën.
 - Piketimi dhe inqizimi i “ Përroit të Dubiqakut”, inqizim i cili do të na shërbej për procedurën e shpronsimit.

a. NËNSTACIONET:

Inqizimi i gjendjes kadastrale të nënstacioneve për ndalje të autobusave për gjatë rrugës magjistrale Prizren-Prishtinë.

- 1. Greikoc 2(dy) nënstacione.**
- 2. Gelancë 2(dy) nënstacione.**
- 3. Gjinoc 2(dy) nënstacione.**
- 4. Topliqan 2(dy) nënstacione.**
- 5. Sllapuzhan 2(dy) nënstacione.**
- 6. Duhël 2(dy) nënstacione.**
- 7. Vendi i quajtur “ QAFA E DUHLËS” 1 nënstacion.**

- Gjatë kësaj periudhe kam pasur takime të ndryshme me përfaqësuesit e INS-it për (Planin Zhvillimor të Komunës).
- **- SWAT analiza për planin zhvillimor të Komunës, faza e parë dhe faza e dytë nga Drejtoria e Shërbimeve Pronore-Juridike dhe Kadastër është përgatitur dhe është prezantuar para INSI-t.**
- Gjithashtu gjatë kësaj kohe janë kryer punë plotësuese si konsultime dhe sygjerime me pale, të interesuar rreth çështjeve pronësore , juridike, konsultime me pale lidhur me kërkesat për marrje në shfrytëzim të pronës komunale në Zonën Industriale në Suharekë.

Drejtoria e Inspekcionit

1.Shërbimi i Inspeksionit gjatë kësaj peridhe ka kryer kontrollime inspektuese në lëmin e kopetencave të fushave përkatëse dhe në bazë të ligjeve të aplikushme dhe vendimeve komunale.

Drejtoria e Inspeksionit sipas vprimtarive përkatëse që ushtrojnë inspektorët në këtë raport vjetor është marr me:

- Nga të gjithë Inspektoret përparsi e veçantë i është kushtuar kërkesave të paleve dhe i është dhënë përgjigje adekuate në afatin e paraparë ligjor.
- Inspektimin e ndërtimeve me leje dhe pa leje ndërtimore
- Luftimin e informalitetit në biznese dhe mbrojtjen e konsumatorve.
- Mbikqyrja e operatorve të transportit rrugor të udhëtarëve dhe taksistëve.
- Mbikqyrja dhe mbrojtja e ambientit.
- Mbyqyrja sanitare e bizneseve dhe rregullesisë higjienike të ujit të pijes në Komunën tonë.
- Mbikqyrja e qarkullimit të pesticideve dhe imputeve bujqësore.
- Percjellja e qarkullimit të produkteve me perjardhjen animale dhe mbrojtja e shëndetit të kafsheve.
- Janë kryer dhe punë të ndryshme administrative.

02. Inspektoril I NDËRTIMIT Duke u bazuar në detyrat dhe përgjegjësit e sektorit të inspeksionit të ndërtimit, gjatë kësaj periudhe janë kryer këto punë:

- Janë ndërmarr masat e sigurisë për ndalimin e ndërtimeve pa leje
- Janë kontrolluar punimet ndërtimore, paisjet, aparatet, përpunim dhe finalizim, si dhe prodhimet në të gjitha fazat e prodhimit dhe në të gjitha vendet ku gjenden dhe dokumentacionin tjetër të nevojshëm me qëllim të mbikëqyrjes së zbatimit të dispozitave ligjore,
- Pjesmarrja në punën e objekteve ndërtimore për të verifikuar dokumentacionin e nevojshëm rreth ndërtimit të objektit sidomos për leje ndërtimore,
- Aplikoj masa të parandaloj ndërtimet pa leje
- Lëshuan urdhëresa dhe ndalesa të përkoshme, sipas rregullave ligjore për evitimin e parregullësive apo të mungesave gjatë kryerjes së punëve për një afat të caktuar kohor etj.

03. Inspektori I TREGUT Sektori i tregut është përqendruar në këto aktivitete:

- Gjatë kësaj periudhe vjetore, inspektori i tregut i ka kryer detyrat e punës kompetencë sipas Ligjit mbi Inspektoratin e Tregut

-Ligjin për mbrojtjen e konsumatorit

-Ligjet tjera të lëmisë përkatëse, udhëzimeve administrative dhe vendimeve

-Kemi marrë pjesë në aksionet sipas kërkeses nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (Për vendosjen e flamujve) nga Ministria e Punëve të Brendshme (për bizneset ilegale)

Nga Ministria e Ekonomisë dhe Financës, Inspektimin e lojrave të fatit dhe mbylljen e tyre sipas vendimit të Ministrisë së Financave etj.

04. Inspektori I KOMUNIKACIONIT

- Gjatë periudhës Janar- Dhjetor 2019 është përcjell gjendja e Komunikacionit rrugor në tërë territorin e Komunës së Suharekës, konform ligjeve dhe rregullave në fuqi.

-Inspektuam dhe kontrolloam automjetet, stacionin e autobusëve, kontratat dokumentet e transportit dhe dokumentet tjera që kanë të bëjnë me punën dhe veprimtarinë e ndërmarrjeve.

-Zbatimin e dispozitave ligjore dhe rregulloreve nga personat fizikë dhe juridik, që kanë të bëjnë me zhvillimin e veprimtarisë së rregullit të transportit publik të udhëtarve dhe mallrave në territorin e Komunës Suharekë, po ashtu edhe inspektimin për leje pune, licencë, regjistrim të biznesit e dokumente tjera të përcaktuara me ligjet dhe rregullat e aplikueshme

-Mbikqyrja e përgjithshme me ligj për zhvillimin e veprimtarisë së transportit të udhëtarve me Taksi etj

05. Inspektori i AMBIENTIT

-Kontrollimi i sipërfaqeve publike (rrugëve, shesheve, trotuarve, sipërfaqet e gjelbruara si dhe vendet tjera publike)

-Gjatë tërë vitit është përcjellë gjendja e përgjithshme e mjedisit në tërë territorin e Komunës Suharekës, sipas planit përkatës konform ligjit dhe rregullave në fuqi etj.

06. Inspektori SANITAR

-Ka mbikëqyrë zbatimin e dispozitave ligjore dhe rregulloreve nga personat fizikë dhe juridik, që kanë të bëjnë me fushën e shëndetit publik duke përfshirë në radhë të parë

inspektimin dhe kontrollimin sanitar të lokaleve afariste-hoteliere në territorin e Komunes së Suharekës.

-Inspektori sanitar ka bërë mbikqyrje sanitare në objekte industriale-ushqimore, tregtare ushqimore, shëndetsore, hoteliere, parashkollore, shkollore, objekte të higjenes personale dhe publike etj.

07. Inspektori i BUIQËSISË

-Bëri kontrollime inspektuese duke u bazuar në Ligjin mbi inspeksionin e Bujqesisë dhe dispozitave tjera ligjore të kësaj lëmie

-Inspektoi punimet në bujqësi, kontrollimin e materialit fidanor në prodhim dhe në qarkullim, kontrollon repromaterialin bujqësor etj.

08. Inspektori PËR VETERINARI

-Bashkëpunim me inspektorët e AUVK :

-Kontrollim i të gjitha veprimtarive zejtare, të cilat merren me përpunimin dhe servisimin e ushqimit me prejardhje shtazore, kryesisht të produkteve të mishit qumshtit dhe nënperiodikëve të tyre.

- U kujdes për mbikëqyrjen dhe inspektimin e thertoreve etj.

Në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitutional kemi bërë inspektime të përbashketa me inspektoret e punës dhe inspektorët sanitary, të nivelit qendror duke u bazuar në kërkesat dhe ankesat e palëve si dhe kemi bashkëpunuar ngushtë me Policinë e Kosovës-Stacioni Suharekë.

Gjatë kësaj periudhe, kemi patur bashkëpunim edhe me inspektorët e veterines, inspektorët e tregut dhe me inspektor sanitar të Kosovës – Agjensionin e ushqimit dhe Veterinës së Kosovës dhe Policinë e Kosovës.

Orari i punës është zgjatur shpesh here dhe është punuar në ditë vikendi, po ashtu duke punuar edhe në orët e vona të mbrëmjes, bashkëpunim me institucionet tjera, si Policinë e Kosovës dhe inspektoret e ATK së dhe të AVUK.

Nga të gjithë inspektorët, përparsi e veçantë i është kushtuar kërkesave të paleve dhe i është dhënë përgjigjeje adekuate në aftin ligjor.

Punën specifike të shërbimit të inspeksionit po e paraqesim si më poshtë:

Procesverbale	1222
Urdhëresa për eliminimin e të metave	446
Aktvendime	336
Kërkesa për kundervajtje në Gjykatë	29
Dënime mandatore	54
Kontrolli i ndërtime pa leje	37
Kontrolli i ndërtimeve me leje	48
Rrënimi i obekteve pa leje dhe rrezikshmëri	36
Vazhdim i rendit të udhëtimit	24
Mjete të inkasuara nga therrjet	1362
Mjete të inkasuara nga pranimet teknike	5.480.00 E
Refuzim në pranime teknike	64
Pranime teknike	116
Mall i asgjësuar në kërkim të pales	45 kg
Konervimi i objektit me shirit rrethues	7
Mbyllje të lokaleve	10

Drejtoria e Arsimit

Drejtoria e Arsimit, ka planifikuar realizimin e objektivave komunale për zhvillimin e arsimit dhe objektivave kombëtare dhe strategjike të MASHT, të cilat kanë qenë pikësypnëm në hartimin e plan- programit të punës për vitin shkollor 2018/2019.

Në këtë kontest janë planifikuar këto objektiva :

- Ngritja e cilësisë në mësimdhënje dhe mësimnxënje në shkollat tona;
- Ngritja e suksesit të nxënësve dhe rritja e nivelit të vijueshmërisë së nxënësve në procesin edukativo-arsimor;
- Realizimi i plan-programeve mësimore;
- Ngritja profesionale e mësimdhënësve;
- Ndërtimi, renovimi dhe rregullimi i objekteve shkollore;
- Rregullimi, pastrimi dhe mirëmbajtja e ambientit të brendshme dhe të jashtëm të shkollave;
- Monitorimi i punës në të gjitha institucionet shkollore;
- Bashkëpunimi me donatorë të jashtëm e të brendshëm për investime në shkolla.

Në kuadër të shkollave amë (SHFMU) funksionojnë edhe 12 paralelet të ndara (shkollat satelit) që rezulton se në total mësimi organizohet në 41 objekte shkollore.

Është me rëndësi të theksohet se një numër i madh i shkollave të komunës sonë mësimin e zhvillojnë vetëm në një ndërrim : 22 SHFMU si shkolla amë, 7 paralele të ndara fizike dhe SHML “A. Ramaj” në Shirokë.

Kuadri : Në arsimin parafillor, fillor ,të mesëm të ultë dhe të mesëm të lartë kanë qenë të angazhuar 964 punëtorë prej tyre janë 784 mësimdhënës dhe pjesa tjetër staf administrativ –teknik.

OBJEKTIVAT E REALIZUARA :

- **Suksesi i nxënësve**

Klasat	Nr. i paral.	Pozitiv	Negativ	Pa notuar	Gjithsej	Mungesat		
						A	PA	GJ
I-V	250	4047-97.9%	88 – 17.37%	125 - 2.93%	4260	12135	3867	16002
VI-IX	190	2307-70.3%	976- 29.73%	119-3.5%	3402	17176	8845	26020
X-XII	103	7626 - 78.9%	567- 24.14%	97 – 4.13%	2252	6662	6263	12945

- **Regjistrimi i nxënësve në klasat e I-ra dhe klasat e X-ta**

DKA në bashkëpunim me shkollat fillore ka planifikuar numrin e paraleleve dhe numrin e nxënësve për regjistrim në paralelet parafillore dhe klasa të para. Sipas këtij planifikimi dhe në mbështetje të UA nr. 16/2004 të MASHT është realizuar edhe regjistrimi i të gjithë fëmijëve të moshës pesë vjeçare në paralelet parafillore dhe fëmijët e moshës gjashtë vjeçare në kl. I-ra

-Regjistrimi i nxënësve në klasë të X-ta në afatin e qershorit dhe gushtit është realizuar në bazë të konkursit të shpallur nga DKA sipas nevojë të tregut të punës dhe kërkesave të shkollave.

- Gjatë vitit 2019 nga DKA janë vizituar të gjitha institucionet shkollore për :

-Kontrollimin dhe marrja e informatave për dokumentacionin pedagogjik dhe administrativ

-Numrin e paraleleve dhe ndarjen e orëve mësimore

-Funksionimi i organeve qeverisëse dhe profesionale

-Kadri

-Gjendja e objektit shkollos dhe ambienti i jashtëm

- Menaxhimi i buxhetit

- Performanca e mesimdhënësve

-Organizimi i mësimi plotësues dhe shtues.

-Hartimi dhe realizimi i PZSH dhe planeve vjetore të shkollës, drejtorit të shkollës dhe stafit tjetër.

Për të gjitha SHFMU dhe SHML janë hartuar Procesverbalet e incizimit të gjendjes së bashku me rekomandimet për të eliminuar lëshimet e konstatuara. Të gjitha procesverbalet e shkollave janë të protokoluara dhe të nënshkruara nga DKA-ja.

Drejtorët e shkollave, janë duke punuar në eliminimin e të gjeturave gjatë vizitave në këto institucione.

• **Aplikimi dhe realizimi i plan-programeve të punës** :Në bazë të vizitave-monitorimit që ka bërë DKA-ja dhe raporteve të shkollave në kuadër të tri niveleve të edukimit rezulton se plan-programet e punës dhe ditët e mësimit-punës të planifikuara me kalendar shkollor nuk janë realizuar.Shkaku kryesor i humbjes së orëve mësimore ishte greva e mesimdhënësve e organizuar nga SBASHK-u. Shkollat të cilat kanë humbur ditë-orë mësimi për shkaqe objektive në periudhën e pare të vlerësimit duhet hartuar orarin për kompensimin e ditëve të humbura sipas planifikimit për kompensimin e ditëve dhe javëve të mësimit-punës për vitin shkollor 2019/2020 të haratuar nga DKA të cilin edhe duhet ta realizuar.

• **Vlerësimi i performancës:** DKA në kuadër të aktiviteteve ka monitoruar ecurinë e vlerësimit dhe angazhimit të punës së mesimdhënësve në procesin e mesimdhënies –performancën me synim të ngritjen e cilësisë në mesimdhënie dhe mesimnxënje. Pyetësi u është shpërnda drejtorëve të shkollave me ndihmën e të cilit do t'i marrim informacionet e sakta për përgatitjen dhe angazhimin e mesimdhënësve gjatë orës mësimore, realizimin e plan- programit mësimor dhe ngritjen e suksesit të nxënësve .

• **Zhvillimi profesional i mesimdhënësve** : Për zbatimin me sukses të Kurrikules së Kosovës dhe për të qenë në rrjedhë të ndryshimeve që po zhvillohen në sistemin arsimor ,DKA dhe MASHT ka organizuar trajnime për të gjithë mesimdhënësit e shkollave që janë të përfshira në zbatim të kurrikules ndërsa DKA në mungesë të planifikimit të buxhetit (mjeteve financiare) nuk ka planifikuar mundësi të ngritjes profesionale dhe pse është e domosdoshme për licencimin e mesimdhënësve edhe pse ka kërkesa të shumta nga mesimdhënësit .

Në bazë të vëzhgimeve në teren dhe raporteve të shkollave rezulton që zbatimi i kurrikules përkundër vështirësive fillestare me trajnimin e mesimdhënësve dhe konsultime në teren kemi arrit që t'i tejkalojmë këto vështirësi.

Mësimdhënësit e fushave përkatëse të kurrikulës në nivel të aktiveve profesionale mbledhen së bashku për të hartuar planet dy mujore për t'i përshtatur njësitë dhe temat mësimore gjatë planifikimeve mujore dhe javore. Pa ashtu janë mbajtur takime të shumta së bashku me mesimdhënësit lidhur me detyrat dhe përgjegjësitë, vështirësitë , diskutime rreth vlerësimit të njohurive të nxënësve ,plotësimit të dosjes dhe punë të tjera.

Gjatë bashkëpunimit të secilit grup në fushat përkatëse mesimdhënësit me punën ekipore kanë dhënë rezultate të cilat reflektohen edhe në mënyrën e metodologjisë të mesimdhënies, strategjive bashkëkohore të mesimdhënies si dhe në shkëmbimin e materialeve ,linçeve të ndryshme dhe literaturës shtesë etj. Duke e parë vështirësitë e drejtorëve të shkollave në hartimin e PZSHSH ,planeve vjetore të shkollave dhe plan-programeve të organeve qeverisëse dhe profesionale në shkolla DKA ka hartuar Udhezuesin për drejtor të shkollave për hartimin e këtyre dokumenteve me rendësi të për institucionin.

DKA ka hartuar Plan-programet e punës së kujdestarëve të klasave për të gjitha nivelet (I-XII) dhe ka kërkuar nga drejtorët e shkollave dhe mesimdhënësit që t'i mbajnë orët

dhe ta menaxhojnë situatën në shkollat e tyre si dhe të bashkëpunojnë me komunitetin në përgjithësi për parandalim të dukurive negative .

Takime të rëndësishme të DKA-së:

-Takimet e rregullta javore konsultative të drejtorëve komunal me kryetarin e komunës

-Takime pune me inspektorët e punës në Prizren

-Takime pune me inspektorët e arsimit të SIA-së në Prizren

-Takimet mujore zyrtare në MASHT

-Takimet në asamblenë komunale

-Takimet javore me stafin e DKA-së

-Takimet mujore me drejtorët e shkollave.

-Takime të ndryshme me organizata dhe donatorë për realizimin e projekteve për ngritjen e cilësisë në arsim.

♦ **Konkurset:** Gjatë këtij viti janë shpallë konkurse dhe janë mbajtur intervista për zgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve të shkollave pas skadimit të mandatit (kontratës). Gjithashtu janë shpall konkurse për zgjedhjen e mësimitdhënësve dhe stafit tjetër sipas nevojave dhe kërkesave të shkollave .

♦ **Rezyme:**

♦ Janë organizuar trajnimet e rregullta për zbatimin e kurrikules;

♦ Është pilotuar testi ndërkombëtar TIMSS;

♦ Është organizuar testi për klasat e nënta “Testi i arritshmërisë”;

♦ Është organizuar testi shtetëror “Matura 2019”;

♦ Është bërë përzgjedhja e kuadrit profesional përmes konkursit të rregullt ;

♦ Është organizuar regjistrimit i nxënësve nëpër të gjitha nivelet shkollore.

♦ Janë organizuar gara, kuize dhe aktivitete të ndryshme për nxënësit;

♦ Ka vazhduar sigurimi i transportit për nxënës;

♦ Janë siguruar donacione në vlera të ndryshme.

♦ Janë nënshkruar disa marrëveshje bashkëpunimi me organizata dhe donator për krijimin e kushteve me të mira në institucionet shkollore dhe ngritje të cilësisë në mësimitdhënje dhe mësimnxënje

♦ **Objektivat për vitin 2019**

- Zbatimi me sukses i kurrikulës në të gjitha shkollat e komunës sonë sipas planifikimeve të MASHT.

- Planifikimi dhe organizimi i trajnime për mësimitdhënës për zbatim të KKK dhe avancim të strategjive të mësimitdhënies dhe mësimnxënjes në shkollat tona

- Funksionalizimi i Aktiveve (grupeve) profesionale në të gjitha shkollat e komunës sonë për zbatimin me sukses të KKK dhe ngritjen e cilësisë në arsim –edukim.

- Zbatimi i UA të MASHT për planifikimin e numrit të paraleleve dhe numrin e nxënësve për regjistrim në paralelet parafillore , në klasa të I-rë. Sipas këtij planifikimi dhe në mbështetje të UA nr 16/2004 të MASHT do të regjistrohen të gjithë nxënësit. Gjithashtu në bashkëpunim me shkollat e mesme dhe me sugjerimet e MASHT do ta bëjmë planifikimin e numrit të paraleleve dhe numrit të nxënësve për kl. të X-ta.

- Në mbështetje të numrit të paraleleve/ nxënësve si dhe fondit të orëve mësimore sipas Kurrikulës bërthamë do të planifikohet edhe kuadri mësimor .

- Shpallja e konkursit dhe pranimi i kuadrit në bazë të normativit për pranim të kuadrit.

- Organizimi dhe mbajtja e testit të klasave të V-ta sipas planifikimeve të MASHT.

- Organizimi dhe mbajtja e testit të arritshmërisë për kl. të IX-ta sipas planifikimeve të MASHT

- Regjistrimi i nxënësve në afatin e parë (korrik) dhe afatin e dytë (gusht) në SHML

- Organizimi dhe mbajtja e provimit të maturës për afatin e qershorit dhe gushtit sipas planifikimit të MASHT.

- Planifikimi dhe organizimi i aktiviteteve jashtë mësimore në kuadër të shkollave.

- Pajisja e shkollave me mjete mësimor.

- Rregullimi dhe meremetimi i objekteve shkollore me prioritet.

-Vizitë- monitorim dhe kontroll i shkollave sipas planifikimit dhe nevoja të shkollave.

Drejtoria e Administratës

Drejtoria e Administratës, në kuadër të fushëveprimtarisë së saj ushtron dhe është përgjegjëse për:

-Ushtrimin dhe zbatimin e shërbimeve të përgjithshme administrative për organet administrative dhe organet tjera Komunale dhe Ofrimin e shërbimeve administrative, për qytetarët e Komunës së Suharekës, në kuadër të kompetencave vetanake apo të deleguara ligjore të saj.

Përgjegjësitë e Administratës:

-Shërbimet e përgjithshme administrative për organet administrative dhe organet tjera Komunale të Drejtorisë së Administratës përfshijnë:

Zbaton dhe bënë regjistrimin dhe mbajtjen e evidences së materialit zyrtar që pranohet dhe dorëzohet nga zyra e arkivit të administratës së Komunës, si dhe arkivimin e lëndës arkivore dhe kujdesi për ruajtjen e saj, dhe kujdesi për ruajtjen e akteve material të administratës (librat amë, kartotekat, protokollet, regjistrat, etj);

Ofron të gjitha format e shërbimeve dhe të ndihmës juridike për qytetarët, përfshirë regjistrimin e të gjitha kërkesave dhe parashtresave të tyre dhe bënë raportimin për kryerjen e lëndëve administrative në përputhje me afatet ligjore.

Është përgjegjëse dhe kujdeset për ofrimin e shërbimeve postare për nevojat e organeve Komunale dhe organeve të administratës Komunale.

Ushtron dhe menaxhon me fushën e logjistikës, duke përfshirë menaxhimin dhe kujdesin për automjetet, titular pronësor i të cilave është Komuna e Suharekës.

Organizon dhe kujdeset për mirëmbajtjen e objekteve të administratës komunale, duke përfshirë organizimin e shërbimeve të sigurimit për këto objekte.

Ushtron të gjitha punët rreth përkujdesjes dhe mirëmbajtjes së teknologjisë informative dhe avancimit të saj për nevoja zyrtare.

Kryen edhe punë të tjera, në bazë të ligjeve të aplikueshme në kuadër të fushëveprimtarisë së Drejtorisë.

Me qëllim të ushtrimit të funksioneve të përcaktuara me dispozitat ligjore në fuqi, Drejtoria e Administratës është e organizuar në këta sektorë:

1. Sektori i Gjendjes Civile
2. Sektori për Shërbime të Përbashkëta
3. Sektori i Arkives
4. Sektori kundër Diskriminimit.

Për periudhen Janar-Dhjetor, janë paraqitur gjithsej 85,564 kërkesa të ndryshme, përfshirë të gjitha dikasteret e Komunës.

Sektori i Gjendjes Civile përveç dokumenteve të lëshuar si Ekstrakt të ndryshme, çertifikata të ndryshme, deklarata të bashkësisë familjare, ka lëshuar edhe një numër të Aktvendimeve si në tabelë.

RAPORTI VJETOR 2019- Aktvendimet

2019	Regj. Lindjevesë	Regj. Vdekjevesë	Korigjime-Nderime	GjithsejtAktvendime	Deklar.- Vert.-Konf.	PergjigjeGjyk.- PROKURORI.	Përgjigje ARC MPB	Martesa me tehuaj	Per humbjeshtetësie	Per fitimshtetësie	Ekzekutimi i Vendimeve	FletaStatistikore
Janar	1	9	11	21	1	3	3		7	1	37	
Shkurt	4	3	12	19	4	5	2		7	1	26	
Mars	0	4	19	23	5	7	2		7	0	39	
Gjithsejt	5	16	42	63	10	15	7		21	2	102	
Prill	1	3	18	22	4	3	4		9	0	26	
Maj	3	9	13	25	4	16	1		4	0	28	
Qershor	1	3	11	13	1	8	1		5	2	21	
Gjithsejt	5	15	42	60	9	27	6		18	2	75	
Korrik	0	9	21	30	3	1	3		24	1	34	
Gusht	1	17	14	32	2	2	3		39	2	36	
Shtator	3	3	13	19	6	3	4		9	0	28	
Gjithsejt	4	29	48	81	11	6	10		72	3	98	
Tetor	3	7	6	16	0	8	3		10	0	22	
Nëntor	1	7	7	15	4	10	4		7	0	25	

Dhjetor	1	9	7	17	2	4	4		18	1	28	
Gjithsejt	5	23	20	48	6	22	11		35	1	75	
Gjithsejt 2019	19	83	152	254	36	74	34	77	146	8	350	2007

Në kuadër të planifikimit për vitin 2019, Drejtoria e Administratës kishte të paraparë vendosjen e dy E-Kioskave, me qëllim të rritjes së shërbimeve dhe kursimit të kohës së qytetarëve.



Ofrimi i shërbimeve përmes E-Kioskut ka rezultuar në rritjen e performances së Komunës së Suharekës në ofrimin e shërbimeve dixhitale, e gjithashtu ka qenë e mirëpritur nga ana e qytetarëve për faktin se ata janë shërbyer me dokumente të gjendjes civile 24 orë 7 ditë në javë.

Nga data 17.07.2019 deri me 31.12.2019, koha kur janë e implementuar dy E-Kioskat, me dokumente të gjendjes civile janë paisur 1407 qytetarë të Komunës së Suarekës, që nënkupton se një numer i madhë i qytetarëve nuk kanë pasur nevojë të presin shërbime në sportele të gjendjes civile.

Vlera për implementimin e dy E-Kioskeve ka qenë 21,820.00€.

Sipas planifikimit të vitit 2019 Drejtoria për Administratë kishte të paraparë projektin e Montimit të Kamerave të Sigurisë në Qytet.



Projekti i vendosjes së kamerave të sigurisë në qytet, është bërë me qëllimi të rritjes së sigurisë së qytetarëve tanë në Komunën e Suharekës. Ky projekt është implementuar në periudhën kohore Gushtë- Tetor, menaxhimin dhe kontrollin e tyre e bënë Policia e Kosovës.

Në bazë të komunikimeve të vazhdueshëm me zyrtarë përgjegjës të Policisë së Kosovës në Suharekë rezulton se ky projekt ju ka ndihmuar shumë në zbardhjen e shumë rasteve të ndryshme si: vjedhje, aksidente në trafik etj.

Vlera e këtij projekti ka qenë 9,863.80€

DREJTORIA E BUJQËSISË ZHVILLIM RURAL DHE PYLLTARI

- **Ngritja e Serrave** – janë 17 serra nga 0.05/ha, një serrë është 0.03/ha, 3 serra nga 0.02/ha dhe 12 serra nga 0.01/ha. Vlera e projektit 89,000.00 i realizuar 100 %.
- **Rregullimi, Ndërtimi i rrugëve fushore** – janë rregulluar gjithsej 25 km rrugë fushore në këto vende : Suharekë, Vraniq, Mushtisht, Sopij, Dubrav, Reshtan, Krushic, Bllacë,

Semetisht, Budakovë, Leshan, Tërrnje dhe Studençan, ku vlera e projektit ka qenë 110,000.00 i realizuar 100 %.

- **Rregullimi dhe Ndërtimi i Shtallave** – janë ndërtua 11 shtalla ku vlera e projektit ka kushtuar 99,500.00 i realizuar 95 %.
- **Projekti i zhvillimit për bujqësi** - me LDF/ADA ku vlera e projektit me bashkëfinancim 50,000.00 i realizuar 100 %.
- **Fondi Emergjent** – janë dëmshpërblye 173 fermer në blegtori, bletari dhe perime-kulturë, i realizuar 100 %.
- **Furnizimi me material fidanorë** – janë përfitues 77 fermer të fidanëve të llojeve të ndryshme të pemëve dhe hardhisë së rrushit, ku vlera e projektit është 30,000.00 i realizuar 80 %.
- **Furnizimi me pajisje Blegtoral**- makina për mjeljen e Lopëve Qumështore dhe Centrifuga për nxjerrjen e mjaltit, po ashtu edhe 2 Inkubator për çeljen e zogjve në Shpezëtari, vlera e projektit 10,000.00 i realizuar 100 %.
- **Ndërtimi i sistemit të ujitjes për tokat bujqësore – hapja e puseve** – janë përfitues 50 fermer ku vlera e projektit ka qenë 19,500.00 i realizuar 98 %.
- **Subvencionimi i fermerëve nga DBZHRP** – janë përfitues 30 fermer vlera e projektit 15,000.00 i realizuar 100 %.
- **Trajtimi i qenve endacak** – janë trajtuar 300 qenë endacak, vlera e projektit 15,000.00 i realizuar 100 %.
- **Vaksinimi i qeneve shtëpiak** - kundër tërbimit ku janë vaksinuar mbi 1,000.00 qenë, i realizuar 100 %.
- **Shpenzimet nga Mallrat dhe Shërbimet** – janë shpenzuar 12,000.00 për shërbime këshillëdhënëse ku kanë qenë të angazhuar 5 inxhinier bujqësor, po ashtu edhe 2 rojtar pylli të angazhuar për mbrojtjen e pyllit janë shpenzuar 4,200.00 i realizuar 100 %.
- **Vizitë studimore në Ulqin** – janë shpenzuar rreth 2,000.00 i realizuar 100 %.

- **Shërbime teknike** – transporti i masës drusore, vlera projektit 4,500.00 i realizuar 95 %.

Drejtoria për Kulturë, Rini, Sport dhe Mërgatë

Drejtoria për Kulturë, Rini, Sport dhe Mërgatë ka filluar aktivitetet kulturore për vitin 2019 qysh në muajin Janar, fillimisht në fazën përgatitore në hartimin dhe planifikimin e aktiviteteve kulturore, sportive, rinore dhe aktivitetet me mërgatën. Aktivitetet do të zhvillohen në koordinimin me këshillin artistik, OJQ, klubet sportive dhe individ. Për organizimin e aktiviteteve DKRSM është duke u marrë në mënyrë aktive edhe në hartimin e Planit Zhvillimor të Komunës së Suharekës, njëherit edhe përgatitjen e konkursit për sunvencionimin e projekteve të OJQ-ve, klubeve sportive dhe individëve.

Aktivitetet filluan me 21 Janar me organizimin e programit artistik muzikor, letrar. Programi i iu kushtua veprimtarisë politike, patriotike dhe artistike Presidentit historik Ibrahim Rugova. Në orën letrare morën pjesë krijues nga Komuna jonë, nga Tirana, Prizreni, Rahoveci dhe Malisheva. Në programin muzikor u paraqit “GAM Theranda”, ndërsa artistët e artit pamor nga komuna jonë, paraqitën veprat e artit në fushën e pikturës. Fjalimin e rastit e mbajti Kryetari i Komunës z. Bali Muharremaj dhe Halil Morina ku lexoi një referat kushtuar jetës dhe veprës së Presidentit Dr. Ibrahim Rugova.



Aktivitetet për kremtimin e 17 shkurtit - 11 vjetorit ë Pavararësisë së Kosovës u zhvilluan sipas agjendës së paraparë.

Aktivitetet filluan me 16 shkurt me aktivitetin “Ecja e Pavarësisë”, ku nisja u bë nga Qendra e Qytetit të Suharekës dhe vazhdoi deri te “Maja e Bajrakut”.

Në homazhe për dëshmorët dhe martirët morrën pjesë Kryetari i Komunës dhe delegacioni i përbërë prej strukturave politike, njëherit morën pjesë edhe shumë qytetarë të komunës tonë, Në palestrën e sportit u zhvillua turneu në futboll të vogël .



 REPUBLIKA E KOSOVËS	 Komuna e Suharekës	 KOMUNA E SUHAREKËS
Ftesë		
Urime 11 vjetori i Pavarësisë		
Agjenda e aktiviteteve për 11 vjetorin e Pavarësisë së Kosovës Shkurt 2019		
Aktiviteti: Ecja e Pavarësisë Nisja në Suharekë nga parkingu te ura deri te maja më e lartë "Maja e Bajrakut"		
Datë: 16.02.2019 Ora: 7:30		
Aktiviteti: Homazhe Vendi: Varrezat e dëshmorëve dhe përmendoret e herojëve në Suharekë Datë: 17.02.2019 Ora: 10:00 Vendi: Varrezat e dëshmorëve të Gryka e Carralevës Datë: 17.02.2019 Ora: 11:15		
Aktiviteti: Finalja e turneut në futboll të vogël Vendi: Palestra e Sportit "13 Qershori" Datë: 17.02.2019 Ora: 13:00		
Me respekt: Kryetari i Komunës Bali Muharremaj 		

Me rastin e festave të Marsit 7 dhe 8 marsit nën patronatin e Nënkryetares Znj Mihrie Suka u zhvillua një aktivitet kulturor me gratë veterane të shquara në shumë profesione të ndryshme dhe me këtë rast u mbajt edhe një koncer, ku morën pjesë këngëtare të estradës sonë.



Në Qendën për Edukim Kreativ “Shtëpia e Fellbahut”, gjatë periudhës 15 deri me 30 Mars, u zhvillua punëtorja e Artit “Superfuqia Ime”, në punëtori morën pjesë rreth 30 fëmijë dhe të rinjë të komunës sonë, gjatë kësaj punëtorie janë realizuar 5 video projeksione të cilat janë shfaqur në Muzeun e Qytetit në Shuharekë kjo punëtori u mbështet nga DKRSM dhe Universiteti Adelphy nga NY.



Dita përkujtimore e viktimave të luftës:

Këtë vitë shënuam 20 vjetorin e rënies së viktimave civile të luftës. Me datë 26 Mars u organizuan aktivitetet përkujtimore sipas agjendës së paraparë me këtë program: Akademi përkujtimore homazhe dhe aktivitetet sportive tradicionale turneu në Volejboll “Murat Suka dhe Herolinda Berisha” dhe Turneu në Basketboll Agu i Lirisë.





Dëshmori i Kombit Indrit Cara u përkujtua me respekt dhe dinjitet, këtë vit në Komunën tonë me rastin e 20 vjetorit të rënies.

Komuna e jonë ka organizuar një program artistik në bashkëpunim me Bashkinë e Kavajës. Të dy delegacionet bënë homazhe te vendi i rënies së dëshmorit dhe pastaj u realizua akademia përkujtimore që u shoqërua me fjalimet e rastit dhe program muzikor, recitim nga Ansambli i Kavajës, “GAM Theranda” dhe recitim nga aktorja Edona Sopaj.



DKRSM në bashkëpunim me LIDHJA E PEDAGOGËVE TË KULTURËS FIZIKE

Raport për organizimin e garave komunale për SHFMU dhe SHML, femra dhe meshkuj, në volejboll dhe kros 2019.

E martë, 26.03.2019 – u hodh shorti në volejboll për SHFMU, femra dhe meshkuj.

SHORTI I GARAVE NË VOLEJBOLL PËR FEMRA PËR SHFMU (E MËRKURË, 26.03.2019)				SHORTI I GARAVE NË VOLEJBOLL PËR MESHKUJ PËR SHFMU (E PREMTE, 29.03.2019)			
1. D. e Gërkucit	Ora: 13:30	2. Rënda	Ora: 16:00	1. Rënda	Ora: 15:00	2. D. e Gërkucit	Ora: 18:00
3. G. K. Memetbeu	Ora: 14:00	3. D. e Gërkucit	Ora: 16:30	3. G. K. Memetbeu	Ora: 15:30	3. D. e Gërkucit	Ora: 18:30
4. Drita	Ora: 14:30	4. D. e Gërkucit	Ora: 17:00	4. Drita	Ora: 16:00	4. D. e Gërkucit	Ora: 19:00
5. V. P. Shkodran	Ora: 15:00	5. D. e Gërkucit	Ora: 17:30	5. V. P. Shkodran	Ora: 16:30	5. D. e Gërkucit	Ora: 19:30
6. 28 Nentori	Ora: 15:30	6. D. e Gërkucit	Ora: 18:00	6. 28 Nentori	Ora: 17:00	6. D. e Gërkucit	Ora: 20:00
Shërbimi profesional i Qendrës ka qenë i angazhuar edhe në punë të tjera, si janë dhënia e pëlqimit për martesë të hershme para moshës së pjekurisë , kemi pasur 4 raste, pastaj me ndërmjetësimin e shërbimit profesional është bërë regjistrimi i fëmijëve që kanë mbetur pa u regjistruar në Librat Amzë të Lindurve 7 raste ,pastaj përcaktimi i atësisë, amësisë, dhënia e vërtetimeve të ndryshme që janë kujdestar të fëmijëve për rregullimin e dokumentacionit të udhëtimit si pasaporta për të mitur si dhe vërtetime për përkujdesjen e fëmijëve dhe të moshuarve 39 raste , të dhënës së vërtetimeve për përkujdesje apo të moshuarve , por edhe punë tjera të cilat janë në domenin e shërbimit profesional të Qendrës për Punë Sociale.

– Gjatë kesaj periudhe nje vjeqare, sherbimi profesional ka leshua me se 511 Vërtetime që nuk i është hequr aftësia e veprimit dhe që nuk është

nen kujdestari” si dhe vërtetime që nuk ka obligime financiare ndaj personave që është përgjigjes para ligjit për lirim nga shtetësia e Kosovës dhe marrjen e shtetësisë së shtetit tjetër 193 vërtetime. Në kuadër të kësaj janë lëshuar edhe 5 vërtetime për fitimin e shtetësisë së Kosovës ku personat nga shteti tjetër e kanë fituar shtetësinë e Kosovës . Po ashtu kemi lëshua edhe 13 dëshmi për personat e moshuar, që kanë kerkua familjaret e tyre për vize dhe bashkim familjar me ta në vendet europiaane, ku ata punojne. Te gjitha keto vërtetime që janë lëshua janë kompenzuar sipas tarifave të Komunes sone, pra shihet se është shtuar numri i atyre që kanë kerkua vërtetim se nuk gjenden nën kujdestari dhe nuk iu është marrë drejta e veprimit, , për arsye se kanë aplikue për pajisje me armë zjarri ose për punësim si roje sigurimi. Nga Sherbimi i SAS-it është kerkuar për 17 raste për fletëreferim për vazhdimin e asistencës sociale, sidomos për nënat vetushqyese, ku sherbimi i ka vizituar dhe pastaj ka dhënë pelqimin për vazhdimin e asistencës sociale. Po ashtu janë lëshua edhe dëshmi, deklarate dhe vërtetime tjera, në baze të kërkesave të klientëve, QPS-ve tjera, dhe organeve tjera.

Gjatë kësaj periudhe kemi pasur 13 raste ku kanë bërë qytetarët kërkesë për pelqim për trashëgimi, pastaj 5 raste për pelqim për rregullim të pasaportës për të mitur, po ashtu 5 raste për letërnjoftim. Pastaj 39 vërtetime për të moshuarit që janë të vetmuar në familje. Sherbimi profesional i QPS në Suharekë, gjatë këtij viti ka evidentuar dhe është angazhues profesionalisht me dy femijë, nën moshën 18 vjeqare në punë të renda, ku është angazhues në tretmanin e tyre, dhe i ka largue nga punët e renda, në bashkëpunim me familjet e tyre dhe punëdhënësit..

Zyrtarët e sherbimit profesional të QPS kanë marrë pjesë si përfaqësues të qendrës në 20 seanca gjyqësore, me kërkesë të Prokurorisë, Gjykatave, përherë i kemi përfillur kërkesat e gjykatave.

Gjate kesaj periudhe janar-dhjetor 2019, permes sherbimit profesional te QPS ne Suhareke, percillen rastet qe jane te strehuar ne Institucionet dhe OJQ-et e ndryshme, dhe ate:

1. Ne Entin Special ne Shtimje	2
raste	
2. Në Shtepinë e të moshuarve në Prishtinë.....	2
raste	
3. Në SOS Fshatrat e Femijeve në Prishtinë	7
femijë	
4. Në Shtepi Shpresa të Femijëve.....	1
femijë	
5. Në Strehim Familjar më Mushtisht.....	1
femijë	
6. Në Shtepinë Integruese në Prizren.....	3
raste	
7. Në OJQ “Hader” në Prizren.....	1
grue	
8. Ne Shtepinë Integruese në Shtimje.....	2
raste	
9. Në Shtepinë në Komunitet në Shtimje.....	1
rastë	

Zyrtaret e sherbimit profesional, te cilet pjesa dermuese jane edhe te licencuar me licenca per ofrimin e sherbimeve sociale profesionale, gjate vitit kalendarik kane krye nje mori te trajnimeve profesionale te organizuara nga Institucione dhe OJQ te ndryeshme., te cilat mjaft kane ndikue ne ngritjen profesionale te zyrtareve te sherbimit profesional.

Po ashtu rregullisht kemi marr pjese ne takime te ndryshme te organizuara nga SOS-Fshtrat e Femijeve, Shtepi Shprese te Femijeve te Kosoves, OFAM-i, Lidhja e Qendraave dhe institucione tjera. Zyrtaret e sherbimit profesional

vazhdimisht ajne angazgje e dhe ne pune ne terren me angazhime profesionale, si dhe dy here gjate vitit kane vizitue edhe familjet qe kane femije me aftesi te kufizuara qe marrin kompenzim material, pra gjithsejt me keta femije jane krye 64 vizita. Sipas nje llogarie mund te themi se gjate vitit 2019, respektivisht deri me 20.12.2019, sherbime profesional i Qendres per pune sociale ne Suhareke, ka ofruar ndihme profesionale ne me shume se 1.200 raste te ndryeshme.

SHERBIMI I SKEMES SE ASISTENCES SOCIALE

Skema e Asistences Sociale gjate ketij viti ka qene ne suazat e normales dhe nuk ka pasur shume levizje, edhe pse ne pergjithesi, rastet e asistences jane ne rritje , dhe keshtu dallon nga muaji ne muaj, pasi qe disa familje largohen nga Komisioni mjekesor, disa te tjera nga ATK-ja, por kohen e fundit edhe disa familje jane largue pasi familjar te tyre kane shkue jashte vendit me kontrate pune.

Keshtu gjate vitit 2019 , per 5 familje ne pozite te veshtire sociale, apo per ndonje semundje te rendet te antarve te familjes, jane ndihmue me ndihm financiare njehershme momentale pran DNS,

Po ashtu per cdo muaj ne DPSF-DNS jane derguar lendet per riaktivizim, fjala eshte per lendet qe nuk kane mundur te riaktivizohen ne bazen e te dhenave ne QPS.

Gjate kesaj periudhe jane leshue edhe 73 vertetime te ndryeshme per nevoja te qytetarve qe jane apo nuk jane shfrytzues te asistence s sociale., apo jane nxenes, student etj.

Shfrytzues te asistences sociale gjithsejt per momentin janë 483 familje me 2502 bashkeshfrytezues, kategoria e I. Jane 335 familje me 1498 bashkeshfrytezues dhe Kategoria II. 148 familje me 1004 bashkeshfrytezzues.

Keshtu sipas raporteve mujore te SAS-it, numri i familjeve në asistencë sociale shifet sipas kësaj pasqyre tabelare gjatë vitit 2018 ishte.

Nr.r.	Muajt	Numri i familjeve dhe numri i antarëve
1.	Janar	Gjate ketij muaji ne sistence ishin 518 familje
2.	Shkurt	523 familje
3	Mars	523 familje
4.	Prill	514 familje
5.	Maj	510 familje
6.	Qershor	513 familje
7.	Korrik	499 familje

8.	Gusht	494 familje
9.	Shtator	486 familje
10.	Tetor	491 familje
11	Nentor	483 familje
12	Dhjetor	492 familje

R A P O R T SNS-së JANAR- DHJETOR-/2019

	Aktivitetet	Kat: 1	Kat: 2	Gjithsejt:
APLIKIMI	1. Numri i rast. që kanë aplikuar për here të parë	17	23	40
	1.1 Sa prej tyre janë të aprovuar	13	17	40
	1.2 Sa janë në shqyrtim	/	/	/

	1.3 Sa prej tyre janë të refuzuara	4	6	10
RIAPLIKIM	2. Numri rasteve të larguara për mosriaplikim	36	18	54
	2.1 Numri i rasteve që kanë ri-aplikuar	351	286	637
	2.1 Numri i rasteve të larguar për mungesë dokum.	40	55	55
VERIFIKIM	3. Numri total i familjeve të verifikuara/ri-verifikuar	444	342	786
	3.1 Sa prej tyre janë aprovuar	364	303	667
	3.2 Sa prej tyre janë refuzuar/çregjistruar	80	39	119
KOMIS.MJEKSOR	4. Numri i rasteve të dërguara në Komision mjeksor	495	/	495
	4.1 Numri i rasteve të aprov. nga Komis. mjeksor	484	/	484

	4.2 Numri i rasteve të refuz. nga Komis. mjeksor	11	/	11
	4.3 Num.i rast.të kthya nga K.M. për kompl. e dok.	/	/	/

ANKESAT	5. Numri i ankesave të paraqitura nga shfrytëzuesit	10	/	10
	a) Në shkallë të pare (I)	6	/	6
	b) Në shkallë të dytë (II)	4	/	4
	5.1 Numri i ankesave të aprovuara	5	/	5
	5.2 Numri i ankesave të refuzuara	5	/	5
	5.3 Numri i ankesave në shqyrtim	/	/	/
	5.4 Kontestet në Gjykata		/	

	a) Kontestet e pranuar	/	/	/
	b) Konteste të refuzuara	/	/	/

BASHKEPUNIMI:

Qendra për Punë Sociale në Suharekë, e cila vepron në kuader të Drejtorisë për Shendetesi dhe Mirëqenie sociale , gjatë vitit 2019, pos që ka pasur bashkëpunim të madh me Komunën e Suharekës, perkatesisht me kryetarin e komunes, me drejtorinë e DSHMS-sëi, bashkëpunim ka pasur edhe me të gjitha organet tjera komunale, pastaj me QMFK-en, Handikosin, organet e judikatures, Policine e Kosoves, si zakonisht me MPMS-en, perkatesisht Departamentin për Politika Sociale dhe Familjes, pastaj me të gjitha OJQ-et qe si fusheveprimtari kane shërbimet sociale. Bashkepunim të mire ka pasur me të gjitha Qendrat për Mbrojtjen e Gruas dhe Femije, pastaj me SOS-Fshatrat, OSBE-en Caritasin e Kosoves, të gjitha Qendrat për punë sociale të Kosoves, ndersa bashkëpunim i mire ishte dhe do te jete qytetari i komunes sone dhe me gjere.

Në Qendren për punë sociale një numër i studentëve e kanë krye praktiken profesionale, ndersa nga shtatori i vitit të kaluar është i angazhuar një zyrtar për ofrimin e ndihmave juridike falas, ku ne me kerkesë të komunës ia kemi sigurue një zyre të punës, dhe shume qytetar të kategorive të ndryshme perfitojnë ndihmë juridike fala, sidomos qytetarët ne nevojë.

Shume familje ne asistence sociale dhe familje tjera qe kane persona me aftesi te kufizuara, jane ndihmue nga OJQ- te ndryshme , nga qytetare dhe organizata fetare me pako ushqimore, pako higjumnike, veshmbathje dhe

mish, ku QPS ne Suhareke, eshte mirenjohes ketyre organizatave dhe njerezve humanitar.

Për nevoja të Qendres për punë sociale, kjo qender është e furnizuar me tre automjete, prej tyre njeri është i ri, i cili është ble nga Komuna e jonë në dhjetor të vitit të kaluar, ndersa një automjet me kerkesë të kryetarit të komunës ia kemi dhënë në shfrytezim Drejtorisë Komunale të Arsimit.

STRUKTURA E TE PUNESUARVE NE QENDREN PER PUNE SOCIALE

1.Sami Rrakaqi..... drejtor

Sherbimi i punëve profesionale sociale

2.Rreze Feti..... Zyrtares per shërbimeve sociale

3.Mirlinda Spahija..... Zyrtares per shërbimeve sociale

4.Mimoza Bytyqi-Sadikaj.....Zyrtare per sherbime sociale

5.Nderim RamajZyrtar per sherbime sociale

6.Besmir Iballi.....Zyrtar per sherbime sociale

Sherbimi i asistences sociale:

- 7.Enver BerishaUdheheqes i shërbimit të SAS-it**
- 8.Mervete Rexhepaj.....Nepunese e SAS-it(me 8 shtator eshte pensionua)**
- 9.Vasije Ramadani.....Nepunëse e SAS-it**
- 10.Qemajl GashiNepunës i SAS-it**
- 11.Isuf Halitjaha.....Nepunës i SAS-t**
- 12.RefkiBerisha.....Nepunës i SAS-i**

Sherbimi financiar – administrativ:

- 13.Sokol Buzhala..... Nepunës financiar Administrativ.**

Gjithsejt të punësuar në Qendren për punë sociale, janë 13 punëtor.

Suharekë,dhjetor 2019

Raport i Qendrës Handikos

Raport përshkrues

Periudha e zbatimit të projektit/programit e mbuluar nga raport

Prill - Dhjetor 2019

Informacion i përgjithshëm mbi projektin apo programin

TË DHËNAT E PROJEKTIT	
Emri dhe referenca e kontratës	Ftese publike për subvencionimin e OJQ-ve, për projektet për shërbimet e personave me nevoja të veçanta për vitin 2019
Emri i organizatës (përfituesi):	HANDIKOS SUHAREKË
Emri i projektit të mbështetur:	Shërbime rehabilitimi në Qendër e familje për fëmije e të rritur me nevoja të veçanta
Personi i autorizuar për të përfaqësuar OJQ-në	Rexhep Kuçi - Drejtor
Menaxheri i Projektit/programit	Rexhep Kuçi
Vendi i implementimit të projektit apo programit (komuna, raponi, shteti)	Suharekë dhe vendbanimet e Komunës
Shuma e miratuar e mbështetjes financiare	20,000.00 €

Fondet e shpenzuara deri më sot në fund të periudhës raportuese:	20.000.00_€

TË DHËNAT E KONTAKTIT TË OJQ-SË PËRFITUESE	
Adresa e organizatës:	Rruga ,, Skënderbeu ,, p.n. 23 000 Suharekë
Telefoni i kontaktues i organizatës:	029 271 158
Personi përgjegjës për kontakt:	Rexhep Kuçi - Drejtor e menagjer i projektit
Telefoni dhe telefoni celular i personit përgjegjës për të kontaktuar:	Tel-fax 029 /271 - 158 : 049/140-109 044/140 - 109
E-mail adresa e personit përgjegjës për të kontaktuar:	Handikos_th@hotmail.com rexhepkuci@gmail.com
Faqja e internetit e organizatës:	—

1. Arritjet dhe rezultatet e projektit për periudhën raportuese

1.1. Përshkruani deri në çfarë mase janë arritur objektivat e projektit (në bazë të propozimit të projektit për të cilin është miratuar mbështetja financiare).

Mbështetja financiare e projektit nga Komuna e Suharëkës përkatësisht DSHMS mendojme se ka ndikuar në përmbushjen e dy objektivave të projektit.

1.Ngritja e nivelit të cilësisë së jetës së fëmijëve dhe të rriturve me nevoja të veqanta përmes ofrimit të shërbimeve sociale e familjare

2.Kursimi i bugjetit familjar , pas ofrimit të shërbimeve fizio- psikoterapeutike dhe ergoterapeutike si dhe furnizimit me pako ushqimore për familjet në gjendje më të rëndë socio- ekonomike

1.2. Në tabelën e mëposhtme, listo aktivitetet (të listuara si në projekt propozim), bartësit e aktiviteteve, një përshkrim të periudhës kohore në të cilën ato zbatohen, si dhe rezultatet dhe treguesit e aktivitetit:

Emri i aktivitetit	Bartësi i aktivitetit	Përshkrimi i aktivitetit të kryer	Periudha kohore	Rezultatet aktuale dhe treguesit (indikatorët)
Vizita në teren	Menagjeri e ergoterapeuti e punëtori social	Identifikimi i rasteve dhe nevojave të tyre	Nga prilli 2019 e në vazhdimësi	Evidentimi i rasteve të reja me nevoja të veqanta dhe furnizimi i tyre me pako ushqimore
Takime me institucione lokale	Menagjeri e punëtori social	Shkëmbim informatash dhe referime për inst. Arsimore e	Në vazhdimësi	Plotësimi i data bazës me informata

		shëndetësore		
Sherbime fizioterapeutike primare	Assistentja e fizioterapisë	Ushtrime bazike nga fiziterapia dhe në vegla	Nga dy here në javë	Parandalimi i komplikimeve
Tretmane edukative dhe logopedike	Psikologu Logopedja	Aktivitete zhvillimore	Nga dy here në javë	Numër më i madh i fëmijëve në shkollë të rregullt
Aktivitete ergoterapeutike	Ergoterapeutja	Furnizim e udhëzim për përdorim të mjeteve ortoprotetike dhe materialit për inkontinence	Në vazhdimësi sipas orarit	Lëvizje më e lehtë pas përdorimit të mjeteve ,kushte më të mira higjienike

1.3. Përfituesit e përfshirë në projekt (gjinia, moshë, vendi ku përfituesit janë, nevojat e tyre dhe veçoritë e tjera të mundshme) si dhe numri i përfituesve të përfshirë në këtë projekt?

Gjatë hartimit të projekt- propozimit është planifikuar që përfitues direkt të jenë 40 fëmijë e 30 të rritur e prej tyre

Meshkuj 25 fëmijë e 15 femra dhe të rritur 19 meshkuj e 11 femra kryesisht të viseve rurale. Nevojat kryesore të përfituesve janë për tretmane nga fizioterapia, psikoterapia, ergoterapia , logopedia, shërbime shëndetësore furnizim me mjete ortoprotetike e material ushqimor e higjienik si dhe njohuri për legjislacionin aktual në Kosovë që ka të bëjë me personat me nevoja të veqanta në mënyrë që ta kenë më të lehtë ti realizojnë beneficionet e mundëshme sipas ligjeve aktuale ne Kosovë .

1.4. Sa përfitues janë të përfshirë në këtë projekt?

Në shërbimet e këtij projekti janë përfshirë 40 fëmijë dhe 30 të rritur, mirëpo kërkesat janë në rritje për numër më të madhë por mundësitë financiare janë të limituara në sigurimin e personelit profesional si dhe transportit të tyre .Gjate kesaj periudhe te implementimit te ketij projekti jane realizuar rreth 4650 seanca nga psikoterapia , fiziterapia , ergoterapia dhe logopedia , e poashtu jane shperndare rreth 300 mjete ortoprotetike si shtreter , karroca te llojeve te ndryshme , kukeza etj.

1.5. Ndikimi i projektit për përfituesit?

Nuk ka diskutim se aktivitetet nga projekti kanë ndikuar në ngritjen e cilësisë së jetës, duke ndikuar në socializimin e tyre , ruajtjen e gjendjes shëndetësore optimale, paisjen me mjete ortoprotetike, kursimin e bugjetit familjar si dhe kërkesat e tyre për aktivitete të tilla në vazhdimësi.

1.6. Cilat janë ndryshimet specifike që ndodhin (në komunitet, në cilësinë e jetës së përfituesve, etj) Si rezultat i aktiviteteve të projektit në këto ndryshime?

Pjesëmarrje aktive e tyre në zhvillimet shoqërore që ndodhin në Komunë , pjesëmarrje në aktivitete sportive e rekreative, manifestime të ndryshme kulturore etj.

1.7. Nëse ka ndonjë mospërputhje gjatë zbatimit të projektit në krahasim me projekt propozimin, ju lutem tregoni cilat ishin arsyet, a është informuar ofruesi i mbështetjes financiare me ndryshimet, dhe si do të ndikojnë ndryshimet në rezultatet dhe objektivat e projektit?

Numri i PNV për trajtim është edhe më i madh , por mundësitë e angazhimit të staf

shtesë janë të limituara.

1.8. A keni hasur në pengesa në zbatimin e projektit në periudhën raportuese? Nëse po, si keni arritur të kaloni ato?

Gjatë implementimit të projektit, nuk kemi hasur në pengesa në implementim ,pasi që kemi në dispozicion mjete të mjaftueshme për transport si dhe mjete ortoprotetike me të cilat furnizohen përfituesit e cekur në projekt dhe të tjerë persona në nevojë. Psh deri në fund të muajit dhjetor janë realizue 4,650 tretmane nga fizioterapia, psikoterapia, ergoterapia e logopedia. Janë shpërndarë rreth 300 mjete ortoprotetike si shtretër, karroca,paterica etj.

1. Bashkëpunimi me partnerët dhe akterët tjerë

2.1. Përshkruani aktivitet konkrete për partnerët organizatën gjatë periudhës raportuese.

Nuk kemi patur partner implementues të projektit.

2.2. Ju lutem tregoni nëse të gjithë partnerët kanë përmbushur detyrimet sipas marrëveshjes në përputhje me aktivitetet e projektit?

N /A

2.3. A është mbajtur partneriteti me sukses dhe në çfarë mënyre? Si e shihni vazhdimin e partneritetit në periudhën e ardhshme? Nevoja për ndryshime (për shembull: takime të

shpeshta, forma të përcaktuara qartë e bashkëpunimit apo të tjera)?
N /A
2.4. Ju lutem tregoni nëse projekti është realizuar në bashkëpunim me akterët tjerë? Përshkruani bashkëpunim dhe ndikimin e këtij bashkëpunimi
Padyshim se bashkëpunimi është në nivel të kënaqshëm me institucionet publike lokale e sidomos me QPS-në, ne shkëmbim të informatave e përvojës, pastaj QKMF në shkëmbim të informatave për shërbimet shëndetësore por më së shumti me ekipen mobile , edhe me disa nga repartet e spitalit rajonal në Prizren
2.5. A ka vazhduar bashkëpunimi me akterët tjerë dhe a ka iniciativa dhe / ose projekte të reja?
Bashkëpunimi vazhdon dhe do të vazhdoj edhe në të ardhmen me institucionet publike lokale , OJQ etj.

3. Projekti i zbatimit

3.1. Tregoni numrin e të punësuarve dhe numrin e vullnetarëve të përfshirë në zbatimin e projektit.
Të angazhuar direkt ne projekt e te kompnezuar nga projekti jane menagjeri , fizioterapeuti, vozitesi e mirëmbajtësi. Në mbarëvajtjen e aktiviteteve kanë qenë edhe staf tjetër i kompenzuar nga donator të tjerë, kurse pjesa voluntere është mbuluar me

percjellës- familjar.
3.2. A ka të punësuar personel të ri me qëllim të implementimit të projektit (të nga përfituesi ose partneri/et)?
Për organizimin e aktiviteteve sa më cilësore janë të angazhuar edhe staf tjetër të kompenzuar nga donator të tjerë , si psikologe,ergoterapeute logopede, punetor social.
3.3. Në çfarë aktivitete janë përfshirë vullnetarët në projekt?
Vullnetaret janë angazhuar kryesisht në aktivitete rekreativo-sportive dhe përkrahje gjatë transportit të tyre.
3.4. A kishte ndonjë ndryshim lidhur me personat që kanë marrë pjesë në zbatimin e projektit krahasuar me projekt-propozimin, në periudhën e kaluar të raportimit? Nëse po, shpjegoni shkurtimisht arsyet.
Jo

2. Forcimi i kapacitetit të organizatës

4.1. tregoni për aktivitetet e ngritjes së kapacitetit të OJQ-së duke përfshirë trajnimet dhe aktivitetet e ngjashme që janë zhvilluar në periudhën raportuese
Stafi i Qendrës, prind dhe edukatore gjatë kësaj periudhe ka marre pjese në disa punëtori - trajnime të organizuara nga Handikos me ligjerues nga Qendra e shëndetit mendor në Prizren, Qendra burimore „Lef Nosi „ në Prizren sipas projektit te perkrahur nga ADA,

4.2. Cilat janë përfitimet e trajnimeve? Me cilat trajnime keni kontribuar në zhvillimin e kompetencave të të punësuarve në organizatë?

Përfitimi i njohurive të reja për metodat e diagnostifikimit, trajtimit e reabilitimit kryesisht të fëmijëve me nevoja të veqanta, pastaj raportet me prindër e komunitetin , pastaj njohuri për ligjet aktuale në Kosovë që kanë të bëjnë me qeshtjen e aftësisë së kufizuar.

5. Monitorimi dhe vlerësimi i suksesit të projektit

5.1. Specifikoni mënyrën që ju keni kryer vlerësimin dhe suksesin e projektit në periudhën raportuese. (A keni bërë vlerësim organizativ të brendshëm apo të jashtëm, vlerësimin të pavarur? Kush e kryen vlerësimin? A kanë plotësuar pjesëmarrësit formularët e vlerësimit? Nëse po, cilat janë rezultatet e analizës.)

Takime të rregullta javore ,por sipas nevojës edhe ditore të menaxherit me stafin e angazhuar në projekt, ku bëhet vlerësimi i vijueshmërisë së klienteve , Punetoret e aktiviteteve raportojnë për vijueshmërinë në aktivitete , interesimin e tyre , si dhe bëjnë vlerësimin për secilin rast individualisht dhe të arriturat shihen në fletëvlerësim. Poashtu edhe mbikëqyresit i projektit në vazhdimësi ka përcjellë implementimin e raportimin sipas projektit.

5.2. Shkurtimisht tregoni rezultatet e vlerësimit të projektit, si dhe metodat që janë

përdorur në procesin e vlerësimit.

Qendra posedon dokumentacion – kartela vlerësimi për secilin rast të cilat plotësohen nga punëtorja e aktiviteteve psh psikologu, fizioterapeuti, logopedi , pra bëhet një punë ekipore poashtu edhe vlerësim ekipor.

5.3. A keni një raport të veçantë për vlerësimin? Nëse po, ju lutem bashkëngjisni atë në shtojcën e këtij raporti.

Po në gjysmën e periudhës së raportimit hartohet raporti narrativ i aktiviteteve, të arriturat por edhe raporti i shpenzimeve.

6. Qëndrueshmëria e projektit

6.1. Si do të përdoren rezultatet e projektit / programit pas përfundimit të implementimit? A ka ndonjë plan për vazhdimësinë e veprimit?

Do të bëjmë përpjekje tek qeveria lokale për vazhdimin e përkrahjes financiare, por edhe te donator të tjerë.

6.2. A ka burime të siguruara për financimin e aktiviteteve pas projektit / programit? Nëse po, nga kush?

Për momentin nuk kemi asgjë të sigurt për qësjtje e fondëve.

7. Buxheti i projektit dhe raporti financiar për periudhën raportuese

7.1. Jepni komentet kryesore në lidhje me raportin financiar dhe devijimit të mundshëm nga buxheti i planifikuar i projektit.

Të gjitha shpenzimet janë kryer ashtu siq janë paraparë në pjesën e bugjetit gjatë hartimit të projektit

7.2. A janë shpenzuar fondet në përputhje me buxhetin e planifikuar, apo ka pasur vështirësi? Ju lutem tregoni vështirësitë e hasura.

Nuk kemi patur vështirësi në implementim të projektit edhe të pjesës së bugjetit , pasi që çdo shpënzim është bërë ashtu siq është paraqitur në tabelën bugjetore , vetem bugjeti per transport eshte ndryshuar por ne kuader te vleres se lejuar.

7.3. A ka pasur marrëveshje për bashkë-financimin e projektit?

Po me MPMS ,pasi që vetëm pjesa e bugjetit nga DSHMS nuk mjaftojnë , kemi patur edhe dy donator – biznese private me vlera solide.

8. Informacione të tjera në lidhje me zbatimin e projektit

8.1. Theksoni arritjet specifike që ndërlidhen me zbatimin aktual të projektit.

Puna cilësore në mënyrë ekipore , paisjet e shumta, material didaktik të mjaftueshëm , hapsirat e objektit etj, kanë ndikuar në punë cilësore me personat me nevoja të veqanta , dhe kjo ka bërë që Handikos Suharekë të fitoj besimin tek pnv , familjarët , komuniteti dhe qeveria lokale për punën e mirë që bëhet.

8.2. Specifikoni bashkëpunimin e arritur gjatë periudhës së kaluar me mediat dhe palët e tjera për aktivitetet që lidhen me promovimin e projektit

Në Suhareke nuk ka TV lokal, por aktivitetet plasohen në rrjetet sociale.

8.3. Cilat janë pengesat kryesore që hasen gjatë zbatimit të projektit? A i keni tejkaluar me sukses dhe si? Cilat kanë qenë mësimet kryesore që lidhen me këto pengesa dhe mënyrat për t'i kapërcyer ato (ose arsyet që ju kanë penguar që ta bëjë këtë)?

Me përkrahjen materiale nga, Komuna e Suharekës, MPMS dhe donator të tjere janë krijuar kushte optimale për implementimin e projektit.

9. Aktivitetet e planifikuara për periudhën e ardhshme raportuese

9.1. Çfarë aktiviteteesh jeni duke planifikuar në periudhën e ardhshme?

Do të vazhdojmë me organizimin e aktiviteteve zhvillimore me fëmijë e të rritur , aktivitete nga fizioterapia primare, psikoterapia, seanca ergoterapeutike , seanca logopedike me fëmijë, aktivitete rekreative- sportive si dhe kontaktet me drejtorite komunale e OJQ lokale që veprojnë në komunën tonë e regjion.

10. Raporti Shtojcat

10.1. Lista e dokumenteve të bashkangjitura raportit përshkruar (të dhënat, fotografi, artikuj shtypi, etj)

Raporti narrativ deri në fund muajit dhjetor 2019

Vendi dhe data e raportit

Suharekë janar 2020

Emri i plotë, nënshkrimi i personit të autorizuar

Emri i plotë dhe nënshkrimi i menaxherit të projektit

Rexhep KUÇI---Drejtor	Rexhep KUÇI

Drejtoria për Shërbime Publike, Mjedis dhe Emergjencë

RAPORT VJETOR I PUNËS I DSHPME

Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mjedis dhe Emergjencë për gjatë 6 Muajve ka kryer punë me përkushtim dhe angazhim jashtëzakonisht të madh, me punët që kanë të bëjnë me natyrën e kësaj Drejtorie.

Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mjedis dhe Emergjencë ndahet në këto sektore :

1. Sektori i shërbimeve publike
2. Sektori për Emergjencë,
3. Sektori për Infrastrukturë ,
4. Sektori për Mjedis.

Sektori i Shërbimeve Publike-

Gjatë periudhes të vitit **2019**, në Drektorinë e Shërbimeve Publike, Mjedis dhe Emergjencë janë kryer punë të ndryshme që kanë të bëjë me natyrën e punës së kësaj drejtorie. Disa nga punët më të rëndësishme, me të cilat ishin të angazhuar të punësuarit e kësaj Drejtorie ishin:

- Kryerja (përgatitja) e faturave të ujit , rrymës, telefonit , mbeturinave, projekteve të ndryshme , si dhe shumë faturave të ndryshme të komunës.
- Realizimi i vizitave në teren për çështje të ndryshme (strehim, kanalizim, ujësjellës dhe infrastrukturë),
- Lëshimi i dokumenteve për persona fizikë dhe institucione,
- Angazhimi në komisione të ndryshme në Komunë,
- Në bashkëpunim të ndërsjellë me disa drejtori të KK, (Drejtorin e Urbanizmit, Zyren e Prokurimit dhe Drejtorin e Arsimit (DKA) e tjera) ,pastaj me “Hidro-regionin Jugor” njësia Suharekë “ Eko-regionin “ njësia Suharekë , KEDS-in , PTK-në etj.
- Po ashtu DSHPME ka kontratë për mirëmbajtjen e ndriçimit publik në Komunë(Suharekë, Reshtan, Studençan, Samadrexh, Shirokë, Peqan, Njëpërbisht, Tërrnje, Leshan, Topliqan, Gelancë, Stravoqinë, Mohlan, Reqan, dhe Dobërdelan.
- Kontratë Mirëmbajtja dimërore e rrugëve lokale, ku gjatë kësaj periudhe kemi bërë 3960 orë punë efektive, janë hargjuar 224000 kg kryp, janë pastruar gjithsej 153 km Rrugë.
- Po ashtu ky sektor ka kontratë me Ekoregionin për Mirëmbajtjen dhe Pastrimin e Qytetit për:
 - Pastrimi i Hapësirave të gjelbëruara me gjatësi =237440 m²
 - Varrezat e qytetit me sipërfaqe prej 236602 m²
 - Pylli i qytetit dhe shtigjet e ecjes me sipërfaqe 132855 m²
 - Pastrimi i shtratit të lumit me një distancë, 4241m'
 - Fshirja e rrugëve me një gjatësi prej =203574m'
 - Larja e rrugëve me gjatësi =136868 m'
 - Mirëmbajtja e banesave kolektive 32 sosh.

Totali i kërkesave të ndryshme të vitit 2019 në DSHPME është gjithësejtë:

Përgjigjet e Kërkesave	Aktpërcjel lësa	Në proces	Miratuar	Refuzuar	Hedhur poshtë	Pezulluar	Total
Nr. i lëndëve	37	9	185	303	0	0	534

Sektori për Emergjencë:

Realizimi i numrit të përgjithshëm të intervenimeve për periudhën e vitit NJ 2019

Gjatë kësaj periudhe gjashtë mujore janë kryer punë dhe aktivitete të përditshme, duke u bazuar në planin e punës, si dhe në kërkesat e paraqitura nga qytetarët e komunës sonë.

Inspektimi pas reshjeve të mëdha të shiut dhe hartimi i raporteve për gjendjen në teren.

Muaji/ Vërtetime	Civil të vravë në luftë	Civil të zhdukur në luftë	Civil të plagosur në luftë	Personat me shërbim ushtarak ish.A.J.
Janar	01	04	00	00
Shkurt	02	02	01	00
Mars	00	18	00	00
Prill	00	00	00	00
Maj	01	01	00	00
Qershor	00	00	00	00

Korrik	00	00	00	00
Gusht	00	00	00	00
Shtator	00	00	00	00
Tetor	00	00	00	00
Nentor	00	00	00	00
Dhjetor	00	00	00	00
Gjithsejë:	04	7	01	00

Inspektori i Preventives së Zjarrit:

Inspektime të rregullta.....	23
Në sektorin Publik.....	2
Në sektorin privat.....	21
Inspektime kontrolluese.....	15
Masa të shqiptuara.....	99
Aktvendime.....	2
Dalje në vendngjarje me rastin e zjarreve.....	4
Pëlqime	4
Vërtetime për raste të zjarreve.....	3
Shkresë mbi gjendjen e MNZ për objekte të larta	1
Raporte nga tereni	5
Dalje në vendngjarje - goditje rrufeje.....	1

Sektori për Infrastrukturë:

Gjatë kësaj periudhe vjetore, Janar - Dhjetor 2019 në këtë sektor janë kryer punë dhe shërbime të cilat kanë qenë të planifikuara me plan dhe program të paraparë për këtë periudhë si në vijim:

- ✓ Menaxhim të projekteve të bartura nga viti 2018 si dhe ato të vitit 2019 gjithsej 5 prej të cilave janë duke u zhvilluar punimet, si dhe menaxhimi i projekteve të drejtorive tjera.
- ✓ Mbikqyrje të projekteve të bartura nga viti 2018.
- ✓ Organizimi i takimeve për diskutimin dhe vlerësimin e gjendjes e projekteve të bartuara, takime të përbashkëta me O. E. – punëkryesit,
- ✓ Komisione pranë zyres së prokurimit (Hapjes së Ofertave dhe Vlersimit të Ofertave),
- ✓ Komisione për vlerësimin e kërkesave të palëve,
- ✓ Komisione për vizita në teren dhe përcaktimin e gjendjes ekzistuese (dëmeve, projekteve, etj.),
- ✓ Hartim të paramasave dhe parallogarive për përgaditjen e inicimit të procedurave për projektet kapitale për vitin fiskal 2019,
- ✓ Përgatitja e dokumenteve nga kërkesat e palëve-raporte etj.,
- ✓ Analiza e buxhetit për vitin 2018 – përgatitja dhe bartja e mjeteve për vitin fiskal 2019,
- ✓ Analiza e projekteve dhe realizimi i pagesave për projekte kapitale 2018 dhe 2019,
- ✓ Përgatitja e dokumentacionit për projekte të ndryshme investive duke filluar nga përgatitja e projekteve ideore e gjerë në finalizimin e plotë të projektit (projekti zbatues), paramasave dhe parallogarit.
- ✓ Takime me stafin e drejtoris dhe O.E. të kontraktuar për PZHK,
- ✓ Trajnim për programin QGIS Essen, etj.
- ✓ Inicimi i procedurave të tenderimit për investimet kapitale 2019
- ✓ Përcjellja e punimeve me organe mbikëqyrse në teren për projektet kapitale të vitit fiskal 2019 si dhe përgatitja e raporteve dhe situacioneve për pagesa të O.E lidhur me projektet në realizim, të cilat e arrijnë sasinë e punimeve të kryera në vlerë rreth 95% të tyre.
- ✓ Përgatitja e dokumentacionit për inicim të procedurave për projektet kapitale në vazhdim për vitin fiskal 2019.
- ✓ Përgatitja e dokumentacioneve, projekteve, paramasave dhe parallogarive për kërkesa për donacione në Ministri të ndryshme si dhe për donator të tjerë.

Projektet Kapitale për vitin fiskal 2019 janë realizuar sipas procedurave ligjore ku disa prej tyre janë të kontraktuara dhe janë realizuar në teren dhe disa prej tyre janë të kontraktuara si projekte shumevjeqare si dhe disa projekte janë në procedurë të prokurimit .

I. Ndërtimi i rrugëve lokale – 6 lot

Lot 1 - Ndërtimi i rrugës "Sylë Duhla, Sadri Guraziu, Ushtria e Kosovës" dhe rrugë lokale tjera në Bllacë, janë kryer 100% të punimeve prej tyre 3,100.00 m² asfalt, 2,450.00 m³ kubëza .

Lot 2 - Ndërtimi i rrugës "Murat Prena, Kadojt, Baki Izlami" dhe rrugëve lokale në Bukosh.

Lot 3 - Ndërtimi i rrugëve lokale në Grejkoc (Perparimi, Liman Brahimi, Haxhi Isufi, Shaban Azmoni, Jakup Kurtishaj, Ali Shaqiri, Jemin Zeqiri, Brahe Zeqiri, Smajl Hyseni) etj.

Lot 4 - Ndërtimi i rrugëve lokale në Reshtan (Rifat Krasniqi, Mehmet Bytyqi segment, Mulliri, Milaim Gashi, Kryezive, Kadri dhe Selman Morina) etj, janë kryer 100%, të punimeve prej tyre 2,827.50 m².

Lot 5 - Ndërtimi i rrugës "Tumat e Gurres, Kosova, Shqiptari, Rrethojat, arat, arari, Drini" dhe rrugët lokale në Studenqan, janë kryer 45%, të punimeve prej tyre 2,100.00 m².

Lot 6 - Ndërtimi i rrugëve lokale në fshatin Samadrexhë (Qeshmja e Cufes, aksi rrugor Avni Hoda, Jeton Kabashi, Shkupi dhe Pojatishtë) etj, janë kryer 70%, të punimeve prej tyre 5,275.00 m².

II. Ndërtimi i rrugëve lokale - 7 lot

Lot 1 - Ndërtimi i rrugëve lokale, Duhel, janë kryer 80 %, të punimeve prej tyre 1385.00 m².

Lot 2 - Ndërtimi i rrugëve lokale në Popolan, janë kryer 80%, të punimeve prej tyre 800.00 m².

Lot 3 - Ndërtimi i rrugës "Qerim Hajdini, Bashkim Maloku, Rexhep Ademi, Halil Hamza" dhe rrugët lokale në Dubrave, janë kryer 100%, të punimeve prej tyre 2,279.00 m².

Lot 4 - Ndërtimi i rrugëve lokale në Gelancë (Ramadan Bajrami, Isuf Qerimi, Kadri Halimi dhe Ramadan Podrimja, Rrakaqet, Sherif Qadraku, Vehap Luma, Avdyll Abazi, Pusi i Atit) etj.

Lot 5 - Ndërtimi i rrugëve lokale "Prespektiva, Mustafaj, Rustem Osmani, Dita Flamurit, Zeqirve (Abazaj), Kovaqit" dhe ndërtimi i urës te lagja "Sopaj" në Mushtisht.

Lot 6 - Ndërtimi i rrugës "Sylejman Berisha", dhe rrugëve lokale në Gjinoc, janë kryer 100%, .

Lot 7 - Ndërtimi i rrugës "Nysret Gashi" dhe rrugët lokale në Peqan, janë kryer 100%, të punimeve prej tyre 2,675.00 m².

III. Ndërtimi i rrugëve lokale - 8 lot

IV. Ndërtimi i rrugëve lokale - 9 lot

V. Projekte me bashkefinancim me MZHR-në

1. Ndërtimi i rrugës në fshatin Budakovë dhe Gelancë- projekt me bashkefinancim me

MZHR : 129.865,00€

2. Projekte me bashkëfinancim me MZHR Ndertimi i 16 nenstacioneve të autobusave

në Komunën e Suharekës : 148,330.35 €.

VI. Projekt me bashkëfinancim me OJQ "Jetimat e ballkanit" - ndërtimi i 15 shtëpive në

komunën e Suharekës,

VII. Projekte me bashkëfinancim me MIT për ndërtimin e rrugëve në komunën e

Suharekës, në vlerë prej : 2,762,709.00 €.

1. Ndërtimi i rrugës Nishor- Kërvasari, Suharekë, në vlerë prej: 145,109.96 €

2. Ndërtimi i rrugës Sopi – Shirokë (Rrethrotillimi Leshan L – 5850 M , në vlerë prej: 699,966.00 €.

3. Ndërtimi i rrugës Ngucat – Javor, në vlerë prej: 162962.12 €,

VIII. Projekt me bashkëfinancim me MMPH

1. Ndërtimi i parqeve në Komunë - Komuna Suharekë , në vlerë prej: 67,660.00 €

2. Ta Pastrojmë Kosovën , në vlerë prej: 100,000.00 €

Investimet kapitale për vitin 2019 të cilat janë të kontraktuara janë kryer në teren dhe kanë arritur vlerën e punimeve deri në 100% ku janë kryer:

105,225.00m` infrastrukturë;

Kubëza të kontraktuara: 17,379.00m`

Asfalt të kontraktuara: 17,541.00m`

kubëza të kontraktuara: 80,881.50 m²,

kubëza të realizuara: 80,881.50 m²,

asfalt e kontraktuar: 62,036.00 m²

asfalt e realizuar: 44,972.50 m².

Vlera e punimeve në projektet kapitale 2019 si dhe projekteve me bashkefinancim me Ministritë të cilat janë kryer deri më tani arrinë vlerën: 4,020,134.51€.

Projektet të cilat janë të kontraktuara në vitin 2018 dhe 2019 të cilat janë kontrata shumëvjeqare janë duke u realizuar dhe duke u menaxhuar nga

Drejtoria e Sherbimeve Publike Mjedis dhe Emergjencë dhe vazhdojnë edhe në vitin 2020, prej tyre:

- 1. Sanimi dhe mirëmbajtja e rrugëve lokale**
- 2. Instalimi dhe sanimi i ndriqimëve publike ne Komune**
- 3. Meremetimi dhe ndërtimi i kanalizimëve**
- 4. Pastrimi dhe rregullimi i lumenjëve në Komunë (Reqan, Mushtisht, Tërrnje, Gelancë, Vraniqi, Semetisht, Leshan, Sopijë etj.)**
- 5. Mirëmbajtja dimërore e rrugëve lokele**

Të gjitha këto projekte janë duke u implemetuar- realizuar dhe arrijnë vlerën rreth 95% të tyre. Po ashtu edhe 5 Projekte Kapitale të vitit fiskal 2018 janë në procedurë të implementimit të cilat janë në finalizim të punimeve për realizimi i tyre.

Janë duke u menaxhuar të gjitha projektet kapitale të vitit fiskal 2018 dhe 2019 si dhe ato të vitit fiskal 2017, po ashtu është punuar në planifikimi buxhetor afatmesëm si dhe planifikimi buxhetor për projektet kapitale për vitin fiskal 2020-2022.

Sektori për Mjedis:

Gjatë kësaj periudhe 6 mujore Janar-Qershor 2019 në sektorin e mjedisit ka pasur kërkesa të shumta për leje mjedisore si dhe pëlqime për vazhdimin e procedurave për licencim, ku gjithësej janë aprovuar 12 leje mjedisore dhe 2 pëlqime, ndërsa 3 leje mjedisore janë në proces.

Me kërkesën e Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës – MMPH, gjegjësisht zt. Fadil Bajraktari - Drejtor i Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës, ku është kërkuar raport mbi gjendjen e zonave të mbrojtura të natyrës në Komunën e Suharekës, Komuna në bashkëpunim me zyrtarë nga Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës, në periudhën e muajit Nëntor të vitit 2018 dhe fillim të vitit 2019 ka dalë në terren dhe kanë bërë verifikimin dhe monitorimin e gjendjes natyrore të 14 vlerave të mbrojtura të trashëgimisë natyrore dhe është konstatuar që tri vlera natyrore kanë pësuar dëme të konsiderueshme nga faktori

antropogjen dhe është propozuar që këto 3 vlera të largohen nga lista dhe të hynë në listë tri vlera të reja natyrore.

Në muajin Mars, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe GIZ-in është vendosur që të bëhet evidentimi i deponive ilegale në tërë territorin e Komunës së Suharekës, ku gjithësej janë identifikuar 125 deponi ilegale kryesisht inerte dhe shtëpiake së madhësisë së vogël, së mesme dhe të mëdha.

Me 22 Prill, me rastin e ditës së tokës është bërë mbjellja e pishave dekorative në fshatin Maqitevë, përgjatë rrugës kryesore, ndërsa me 25 Prill është bërë mbjellja 100 pishave dekorative edhe në fshatin Reçan, përgjatë lumit.

Me datën 24 Prill është mbajtur punëtori lidhur me “Javën e lëvizshmërisë pa makina në Republikën e Kosovës” e cila do të mbahet në muajin shtator, në datat 16 - 22 dhe Komuna e Suharekës është njëra ndër Komunat e cila do ta shënojë këtë ditë.

Gjatë kësaj periudhe ka pasur mbikqyrje të projekteve “Pastrimi i lumenjeve” dhe “Pastrimi i deponive ilegale”.

Në platformën NDREQE.COM vazhdimisht është raportuar në rregullimin e raportimeve të bëra nga ana e qytetarëve, kyesisht është bërë rregullimi i gropave me anë të projektit të sanitimit.

Po ashtu në këtë periudhë 6 mujore ka pasur vizita në terren nga ana jonë.